



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR SHERBIME

(ME NJË OPERATOR EKONOMIK)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njërën anë; dhe

Grupi i Operatoreve Ekonomik “IMPACT” & “Cimi @ ELECTRONIC” Shpk të cilën e përfaqëson, z. Egzon Gashi, nga Fushë Kosova , me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 810844028, ne vazhdim “KRYERSI I SHERBIMEVE”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:

MIRËMBAJTJA DHE ZGJERIMI I RRJETIT TË KAMERAVE TË SIGURISË NË KOMUNËN E ISTOGUT

Nr. I prokurimit	633-20 - 2147 -2-2-1/ FA061
Nr. I brendshëm	633 / 020/ 025/ 221

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave si në vijim:

MIRËMBAJTJA DHE ZGJERIMI I RRJETIT TË KAMERAVE TË SIGURISË NË KOMUNËN E ISTOGUT

Autoriteti Kontraktues bënë Furnizimin vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i

përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të e tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative që Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të kryejnë furnizime të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKATËSISHT ME DATË **04.08.2020** DHE DO TE PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME **04.08.2022**

1.5 Kjo kontratë mund të shkëputet edhe para skadimit të afatit të paraparë në Nenin 1.4 të kësaj kontrate, po që se kontrata permbushet me çmimin e paraparë sipas dispozitave të Nenit 56.10 të Udhëzuesit Operativ ku thuhet se nëse kontrata permbushet me çmim pa marrë parasysh Kohën e zgjatjes dhe nënshkrimin original e njëjta shkëputet automatikisht.

Neni 2 Kushtet e dërgesës:

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e të gjitha **SHERBIMEVE** të jetë: **24 MUAJ nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.**

2.2 Vendi ku do të dorëzohen artikujt do të kryhen shërbimet do të jenë **INSTITUCIONET KOMUNALE TE ISTOGUT, respektivisht do të caktohet nga Drejtorati për Shërbime Publike.**

2.3. Obligimet e kontraktorit janë të gjitha shërbimet përcaktuara në Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve të përgjithshme dhe të veqanta të kontratës.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Kryersi I furnizimeve duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të tyre. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi:

4.1 Kjo kontratë është e lidhur me çmime për njësi. Çmimet njësi të furnizimeve janë të paraqitura në ofertën financiare të kontraktorit dhe totali I çmimit për njësi është 1,888.87 € dhe me shkronja: /**Një mijë tetë tetë dhjetë - 87/100**

Vlera e parashikuar e kontratës është per vitet 2020-2022 është 15.000,00 Euro. Dhe me shkronja: /Pesëdhjetëmijëeuro/

Duke qenë se në këtë kontratë, në dispozitat e Nenit 52 pika 6 të Ligjit per Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092 LPP-së dhe Nenin 56 pika 11 të rregullave dhe Devijimi I lejuar nga kjo vlerë është + - 30%

4.2 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do t'i nënshtrohen ndryshimeve për porosit e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj",

"vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut:

Për Kontraktuesin:

"IMPACT" & "Cimi ELECTRONIC" Shpk


Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri:	<i>Egzon Gashi</i>
Pozita:	<i>Zyrtar përgjegjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>L i d e r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>4/8/2020</i>	Data:	<i>04.08.2020</i>
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentim/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është I OBLIGUAR QE TE PERCJELLE IMPLEMENTIMIN E KONTRATES NE BAZE TE KUSHTEVE TE KONTRATES DHE PARAMSE DHE PARALLOGARISE.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10% E VLERES SE KONTRATES ME VLEFSHMERI 25 MUAJ
Cilësia e furnizimeve	16.2	<i>Të gjitha furnizimet duhet të jenë të cilësisë së lartë.</i> <i>Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas perfundimit te aktivitetit dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimet janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</i>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është:25 muaj
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.


NR	PERSHKRIMI	MUESIA	SASIA	SASIA E PERAFERTE	CENIMI PER MUESI
1	<p>Furnizim dhe instalim i NVR-it me 32 kanale deri ne 12MP</p> <p>NVR duhet te ketë mundësinë e lidhjes deri në 32 IP kamera me kapacitet hyrës (bandwidth) prej min. 320Mbps si dhe te ketë mundësinë e konfigurimit të pavarur për secilin kanal.</p> <p>NVR duhet të ketë minimum 1x HDMI dalje për filmje të montorit ne rezolucion 4K si dhe dalje tjera 1xHDMI dhe 1xVGA full HD 1080p. NVR duhet të ketë përkrash protokolle të shumëllojshme për kontrollimin e kamerave PTZ.</p> <p>NVR duhet të përkrash deri 4 HDD SATA me kapacitet për disk 8TB. Gjithashtu NVR duhet te ketë mundësinë e lidhjes te nje HDDesata</p> <p>NVR duhet të ketë mundësinë e regjistrimit të ngjarjeve ne menyre të vazhdueshme, yertem në lëvizje si dhe mundësinë e aktivizimit të alarmit ne rastet kur kemi lëvizje.</p> <p>NVR duhet te ketë minimum 8 kanale per kamera me funksione smart dhe analiza te ndryshme per njohjen e njeriut dhe automjetëve si dhe filtrim te alarmeve false me qëllim te reduktimit te alarmeve të rrejshme.</p> <p>NVR duhet te ketë mundësinë e dekodimit H.265+ formati cili mundëson ruajtjen e të dhënave në kohë sa më të gjatë në hapshren memoruse te NVR-it</p> <p>NVR duhet të përkrash kamerat në rezolucion deri ne 12MP.</p> <p>NVR duhet të ketë mundësinë e rishikimit të minimum deri ne 12 kamera ne të njëjtën kohë. Gjithashtu NVR duhet të ofroj mundësinë e zmadhimit (Zooming) të ngjarjeve gjatë kohës së rishikimit.</p> <p>NVR duhet të përkrash funksionin AVR (Automatic Network Replenishment) që në rastet kur ka ndërprerje të rrjetit dhe në momentin qe rrjeti funksionalizohet e bënë pranimin e të dhënave në menyre automatike nga kamerat.</p> <p>NVR për lidhje ne rrjet duhet t'i ketë minimum 2 porte të adaptueshme 10/100/1000 RJ45 si dhe minimum edhe portet e komunukimit RS-232 dhe RS485, 2x USB 2.0 dhe 1x USB 3.0. Gjithashtu NVR duhet të ketë edhe minimum 12 hyrje dhe 4 dalje për alarm si dhe një kanal për audio komunikim të dyanshem.</p> <p>NVR duhet të ketë mundësinë e qasjes nga jashtë përmes internetit dhe ti ofrojë mundësitë si në vijim: Kërkimin e inqizimeve, kthimin e tyre, njerjen e inqizimeve, mundësinë e formatizimit të HDD-ve, resetimin e kamerës, kontrollin e kamerave rrotulluese (PTZ). Gjithashtu NVR duhet të ketë mundësinë edhe për komunikim te dyanshem përmes zërit.</p> <p>Konsumi energjis pa kyqje te HDD-ve nuk duhet të jetë me i madh se 35W si dhe me HDD te lidhura ne max 90W.</p> <p>NVR duhet te operoj në temperatura nga -10°C deri 55 °C, të jetë i montueshëm në rek kabinet. Së bashku me broshurën e NVR</p>	COPE	1	1	185.00



<p>Furnizim dhe instalim i-Kamera e jashtme IP bullet 4K (8MP) Kamerë IP 8MP me IR të integruar për distanca deri në 80m Kamera duhet të jetë për përdorim të jashtëm dhe duhet të ketë rezolucion deri në 4K 3840x2106 në 12.5 fps, 3072x1728 në 20fps Kamera duhet të ketë CMOS Sensorë progresiv me 1.1.8"; 1.2.5"; 1.2.7"; 1.3" (nëjërën nga këto formate) të ketë lentën fikse me madhësi 4mm. Kamera duhet të ketë Sensorë të ndjeshëm ndaj dritës për kolor 0.01 Lux dhe jo më shumë se 0.02Lux @FL2 me AGC të kyçur si dhe për bardh e zi kur IR është e kyçur 0 Lux. Kamera duhet , të përkrahe funksionet BLC 3D DNR, WDR 120dB,apo edhe ndonjë funksion tjetër. Kamera duhet të ketë mundësinë e ruajtjes të dhënave në SD Card ne kapacitet minimum 128G, gjithashtu kamera duhet të përkrah funksionin ANR (Automatik Network Replenishment) që në raste kur ka ndërprerje të rrjetit dhe në momentin qe rrjeti funksionalizohet e bënë dërgimin e te dhënave në mënyrë automatike në rekorderin ku do te ruhen të dhënat në qendrën e kontrollit. Kamera duhet të përkrah formatin e kompresimit H.265+ format i cili mundëson ruajtjen e të dhënave në kohë sa më të gjatë në hapësirën e memories te NVR-it Serverit gjithashtu duhet të ketë mundësinë e kompresimit dhe dërgimit te video imazheve në 3 linja të komunikimit në të njëjtën kohë pra duhet te jete (third streams). Kamera duhet të ketë të integruar LED IR me mundësi veprimi deri ne 80 m. Kamera duhet të jetë e mbrojtur sipas standardit IP67 si dhe të e punuar nga materiali (metal). Kamera duhet të jetë kompatible me sistemin ONVIF dhe standardit ISAPI, SDK qe te ketë mundësi për integrim me sistemet e menaxhimit të videove te palës se trette. Gjithashtu kamera duhet të përkrah edhe funksionet si në vijim (Line crossing detection, intrusion detection, face detection) Kamera duhet të ketë minimum këto porte për kyqje RJ45 10 100Mbps Kamera duhet të furnizohet përmes portit PoE (802.3af, 36 V to 57 V), si dhe të ketë mundësinë alternative të furnizohet me rryme me 12VDC. Duke marrë parasysh qe kamera është për përdorim të jashtëm ajo duhet të punoje ne temperaturat prej -30°C ~ 55°C, duhet të ketë mbajtesin adekuat për montim. Së bashku me broshurën e kamerës duhet të dorëzohet CE certifikata për IP Kamerën dhe ISO certifikata e prodhuesit.</p>	COPE	1	10	135.00
--	------	---	----	--------



3	<p>Furnizim dhe instalim-PTZ IP 4MP 32x Optical Zoom, 150m IR Furnizimi i IP-kamerave te tipit speed dome PTZ 360° me mbajtësi për mur/tavan PTZ kamerë për perdorim të jashtëm me rezolucion 4MP (2560x1440 në 30fps), minimum iluminacion 0.006 lux në kolor dhe 0 lux me IR te ndezur. Te kete funksion dite/nahtë IR Cut Filter.</p> <p>Mundësi te furnizimi me 24VAC dhe Hi-PoE si dhe port komunikimi RJ45 10/100m</p> <p>Kamera duhet të jetë minimum 32x optical zoom dhe 16x digital zoom</p> <p>Te ketë integruar Smart IR per distance minimum deri 150m, të ketë funksioni WDR 120DB (Wide Dynamic Range), Defog funksion i cili ne mundeson pamje te paster edhe ne rast te mjegullës.</p> <p>Kamera duhet te perkras dhe te kete mundësinë e vendosjes së SD memories me kapacitetet deri ne 256GB.</p> <p>Kamera duhet te perkrashe kompresimin e videos H.265+ si dhe te kete minimum tri linja te komunikimit (third Stream).</p> <p>Gjithashtu kamera duhet te perkrashe edhe funksione tjera si zbulimi i ndërhyrjes, zbulimi i kallimit të vijës, zbulimi i hyrjes në rajon, zbulimi i daljes nga rajoni, zbulimi i largimit të objekteve etj.</p> <p>Kamera duhet te kete minimum 2 kanale hyrese per alarmim si dhe nje kanale per dalje qe do te perdoren per alarmim per alarmime te ndryshshme te njoftimve ne qendren e montorimit , derftimin e e-mailve etj. Kamera gjithashtu duhet te kete minimum 1 kanale audio hyrje dhe 1 dalje . Kamera duhet te perkras funksionin eregjistrimit te zgjuar dhe analizimit te videos permes funksionve VCA me ane te te mundesohet analizimin e videove rreth përmbajtjes videove dhe është aftësia e analizimit automatik të videos për të zbuluar dhe përctaktuar ngjarje ne kohore dhe hapësirore gjithashtu duhet te perkras edhe funksionin ANR, funksion i cili ne rastet e nderprerjes se rrjetit ky funksion mundeson ruajtjen automatike te dhënat dergohen ne karten e ruajtjes dhe menjehere pasi rrjeti te funksionalizohet ne menyre automatike te dhënat dergohen ne NVR.</p> <p>Mbrojtje minimum IP66 si dhe mbrojtje nga rrufeja dhe mbitesioni sipas standardit TVS4000V.</p> <p>Kamera duhet te operojë ne temperature nga -30°C deri 50°C.</p> <p>Së bashku me broshurën e kameres duhet të dorëzohet CE certifikata per IP Kamerën PTZ dhe ISO certifikata e prodhuesit.</p>	CCPE	1	2	390.00
4	<p>Furnizim dhe instalim i Testatorës se rrjetit per menagjimin IP kamereve</p> <p>Testatura duhet te kete ekran LCD me minimum 128x64 pixel, te kete joystick 4 akse , te kete mundësin e lidhjes dhe menagjimit te shume pajisjeve nga qendra e monitorimit te cilar lidhen ne rrjet , duhet te kete mundësin e lidhjes se PTZ kamereve te rrjetit, te kete mundësi te lidhjes se DVR-ve permes serial portit, te ketri mundësin e regjistrimit te mimum 12 operatorve, te kete mundësin e ngritjes se sistemit te ri permes ngarkimit apo shkarimit te dokumenteve per konfigurim per mose portit USB. Testatura duhet te kete qasje direkt ne rrjet permes interfajsit RJ-45 dhe te konfigurimit permes Web dhe te meengjoj deri ne 500 pajisje. Perver portit te rrjetit per komunikim testatura duhet te kete edhe serial portat RS-232, RS-422 dhe RS-485. Testatura duhet te kete mundësin e furnizimi me tension per mose 12VDC dhe duhet te operoj ne temperaturat nga 10°C deri 55°C. Së bashku me broshurën e Testatures duhet të dorëzohet CE certifikata per IP Kamerën dhe ISO certifikata e prodhuesit.</p>	COPE	1	1	180.00
5	<p>Furnizim dhe instalimi i Kabllit Florit optik 12 fije SM</p> <p>Kabllit optik duhet te jete i tipit single mode 50/125 me 12 fije optike, duhet te jete i pershtatshem per instalime te jashtme , duhet te kete me mbeshqeljeje metalike, te jete rezistent ndaj ujit dhe nga brejstit si dhe nga dëmtimet mekanike. Diamteri i kabllit nuk duhet te jete me i madhe se 1cm, forca elastike duhet te jete min 1450 N, te jete rezistent nga shtypja/ndrydhja minimum 1000 N/100mm.</p> <p>Gjithashtu kabllit duhet te siguroj rezistencen e deshirueshme ne te rrethet apo shtypje.</p>	M ¹	1	1500	3.00



6	Furnizim dhe instalim i kutisë per perdorim te jashtem per terminimin dhe spajsimin e fijeve optike Kuti per terminimin dhe spajsimin e fijeve optike duhet te jete per perdorim te jashtem dhe te jete i kompletuar me kasta te fibrut, LC konektor dhe te gjitha pjeset e nevojshme per spajsim deri ne 48 fijeve optike. Kurta duhet te operoj ne temperatura nga -35°C deri ne 60°C, te jete i mbrojtur nga uji dhe te kete mundesin e montimit ne shtylla.	COPE	1	3	35.00
7	Furnizim dhe instalim i SPLICE CASSETTE – deri ne 12 fije	COPE	1	20	5.00
8	Furnizim dhe instalim i Adapter 12v 5Ah	COPE	1	25	7.00
9	Furnizim dhe instalim i Patch cable SM LC/SC, 2mm, 5m	COPE	1	25	3.00
10	Furnizim dhe instalim i kuties shperdarje OG per perdorim te jashtem me dimensione 300x250x120	COPE	1	15	35.00
11	Furnizim dhe instalim i kuties Dead Clamp(Lidhëse shtrënguese për kabull)	COPE	1	100	1.20
12	Furnizim dhe instalim i Hardiskut 6TB Sata WD Purple Surveillance Storage is built for 24/7	COPE	1	4	170.00
13	Furnizim dhe instalim i Media Konvertor single mode single fiber deri 25km 10/100/1000 Mbps full duplex, dual fiber singlemode, MTBF minimum 100,000h.	COPE	1	5	65.00
14	Furnizim dhe instalim i switchit me 8 porte PoE Gigabit 10/100/100 dhe me 2SFP Full Gigabit switch with 8 PoE	COPE	1	3	80.00
15	Furnizim dhe instalim i SFP module 20KM 1.25Gbps Single Fiber module Transceivers SFP 1x TX1310/RX1550nm, 1 x TX1550/RX1310nm	COPE	1	6	18.00
16	Furnizim dhe instalim i kabullit UTF duhet te jete minimum i kategorise 6 me 4x2x23AWG bakër, te kete mbështetje PVC ne përputhje me RHOS dhe te operoj ne temperatura prej minimum -20 °C deri 70 °C, te jete i testuar sipas standardit ISO IEC11801, TIA-568-C.2.YD T1019	M'	1	200	0.50
17	Furnizim dhe instalim i kabullit per furnizim me tension duhet te jete tipit PP00-Y PP00 me 3 fije me nga 2.5mm duhet te kete izolim nga PVC ngjyre e zeze, i njeiti duhet te jete i pershtatshme per shperdarje te energjise në rrjetat e qytetit. Kabulli duhet te jete konform standardeve DIN VDE 0276, HD 663, IIEC 60 502-1TENSIONI NOMINAL: 0.6/1 kv.	M'	1	400	2.50
18	Furnizim dhe instalim i siguresë elektrike 220V-240V/16A	COPE	1	10	2.00
19	SPASIMI I KABULLT OPTIK	COPE	1	70	5.00
20	INSTALIMI DHE KONFIGURIMI I KAMERAVE	COPE	1	35	95.00
21	Furnizim dhe instalim Monitorit me madhesi minimum 55", te kete rezolucion 4K Ultra HD (3840 x 2160), te jete Smart, te kete moduli te Wifi per mundesi te qasjes ne rrjet, te kete minimum 2 x HDMI per lidhje me NVR si dhe te kete zerim me fuqi minimum 2120W - Monitori duhet te lterohet komplet me 1x HDMI Kabell per rezolucion 4K si dhe mbajtësin adekuat per montim ne muri.	COPE	1	1	450.00
22	Furnizim dhe instalim i SHENJAVE NJOFTUESE PËR VEZHIMIN E QYTETIT ME KAMERA	COPE	1	10	11.67
TOTALI I CMIMIT PER NJESI ME TE GJITHA NGARKESAT					1,888.87

